

URDHËR
Nr. 526, datë 19.3.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin e funksionimit e administratës shtetërore”, të ndryshuar; si dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, zonjës Florenca Korbi, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Kompetencat e deleguara të Sekretarit të Përgjithshëm do të ushtrohen nga data 24.3.2026 e deri në emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Ngarkohet zonja Florenca Korbi për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi